

ETF dhe takimi i vendeve të Evropës Juglindore në procesin e Kopenhagës

Torino, 21janar 2005

Zbatimi i Deklaratës së Kopenhagës në Kosovë

Veçanërisht është me rëndësi mundësia që Kosova të bashkëpunoj me Unionin Evropian , me vendet candidate dhe vendet fqinje në regjion në arsim, trajnim dhe zhvillim më të gjërë të fuqisë punëtore.Kosova vlerësohet nga objektivat e Kopenhagës.

Sado që komplekse Kosova konsideron se transpareca e qështjeve, kualiteti i arsimit dhe trajnimit ,udhëzimet për karrierë,mësimi joformal dhe informal janë të rëndësishme për debate të reformave.

1.Konteksti

Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror i Kosovës është i lidhur me integrimin e saj në të ardhmen në Unionin Evropian. Sipas këtij vlerësimi Kosova i merr parasysht:

- a) Vlerësimet nga vendimet e marra në samitin e Fierës në qershor të vitit 2000 për integrimin e vendeve të Ballkanit Perendimor në strukturën e Unionit Evropian dhe
- b) Rezultatet e samitit të Selanikut në qershor 2003 në mes vendeve udhëheqëse të Unionit Evropian dhe vendeve të Evropës Juglindore të cilat u zotuan se do të përforcohen duke rritur bashkëpunimin në mes tyre të cilat janë në zhvillim e sipër brenda Kosovës.

2. Objektivat

Këto shënime identifikojnë një numër të çështjeve me të cilat Kosova adresohet që për një kohë të shkurtë të përfshihet në principet e procesit të Kopenhagës brenda vendit.Këto shënime kanë për qëllim shpërndarjen e informatave me partnerët e Unionit Evropian dhe kolegëve nga Ballkani Perendimor të cilët konsiderojnë se do të jenë pjesëmarrës të Kopenhagës me reformat dhe zhvillimet e veta.

3.Zbatimi i Kopenhagës në Kosovë

Kosova tani është e angazhuar në politikën e zhvillimit institucional për të përkrah sa më shumë ekonominë konkurruese dhe fuqinë punëtore të aftë për të konkuruar brenda Evropës së gjërë.

Një numër i zhvillimeve kyçe kanë filluar dhe reflektojnë disa çështje të deklaratës së Kopenhagës. Kjo konfirmon se prioritetet e Kosovës janë themeluar mirë.

Sidoqoftë interesi i Unionit Evropian është për të përkrah Kopenhagën në Kosovë (dhe Ballkanin Perendimor) të cilat do të përforcohen me ndihmën e punës që është në rrugë e sipër në Kosovë.

Zhvillimet përmbledhëse kyçe në Kosovë me rëndësi të veçantë për procesin e Kopenhagës janë:

- Prezentimi i sistemit të klasifikimit të profesioneve të bazuar në nevojat e tregut të punës
 - Hapat fillestar në zhvillimin e udhëzimeve për karrierë
 - Reforma e kurrikulave gjenerale dhe profesionale në shkolla qendra trajnuese për të rritur, prezentimin e edukimit me nxënësin në qendër dhe trajnimin.
 - Zhvillimi i standardeve të arsimit profesional dhe certifikimet (Kurrikulat , trajnimi mësimdhënësve, bartësit e trajnimit).
 - Zgjerimi i politikës së zhvillimit të fuqisë punëtore dhe zhvillimi institucional
- Statistikat, politika përmes partnerëve shoqëror të institucione

Sipas këtij vlerësimi Kosova do të koncentrohet në ngritjen e vetëdijes së çështjeve të Kopenhagës në vend por me :

- a) Referenca specifike për standardet e kualifikimeve dhe standardet e arsimit profesional dhe trajnimit
- b) Udhëzimet për karrierë. Qëllimi këtu është të zhvillohet puna në bazë të dialogjeve të partnerëve dhe zhvillimeve aktuale.

Propozimet për masat e Kopenhagës në vitin 2005

Tri masat janë propozuar të zbatohen në vitin 2005:

- a) Do të formohet grupi për zhvillimin e kualifikimeve nacionale (GZHKN) Ky do të jetë kompromis nga përfaqësuesit e MASHT-it ,MPMS, MTI ,partnerët shoqëror, shoqëria civile.

Detyra kryesore e grupit do të jetë të përpiloj: Letrën e perspektivës së Kopenhagës që t'i prezentohet këshillit tri palësh (TAC) si hap i parë në përcaktimin e implikimeve politike që duhet të përcillen nga qeveria dhe partnerët shoqëror.

“Letra e perspektivës” do të paraqitet në nëntor të vitit 2005 tek Këshilli Tri Palësh

- b) Duke ndërmarrë "ndërtimin e bllokut" grupi i kualifikimeve nacionale do t'i zbatoj veqanërisht standardet e arsimit profesional dhe kualifikimet.
Kjo do të përfshijë grupet punuese me ekspert të Kosovës , të mësuarit nga të tjerët
pra nga vendet e kandiduara në Unionin Evropian apo institucionet, politikat dhe mekanizmat e Kopenhagizuara për zhvillimet në vazhdim të kualifikimeve profesionale në Kosovë.

Sipas këtij vlerësimi Kosova do të arrij ndërtimin e një bashkëpunimi të fortë shoqëror me objektiva të cilat sigurojnë kualifikimet profesionale dhe orientimin e tregut nga nivelet e kualitetit të kërkuar nga tregu vendor por me perspektivë eventuale për tregun e gjërë regjional dhe Evropian.
Duke marrë parasysh zhvillimet fillestare për udhëzimet për karrierë përkrahur nga Agjencioni Evropian për Rindërtim (EAR) në vitin 2004 dhe planet e ardhshme në 2005 të përkrahura nga AER dhe mund të themi se progresi në këtë fushë i përket Kopenhagës.

Për këtë Kosova tenton që t'i shfrytëzoj mundësitë e përkrahjes së Unionit Evropian në vitin 2005 për tu integruar në principet e Kopenhagës në diskutimet për udhëzimet për karrierë, politikën dhe planet institucionale.

Përkrahja për Kopenhagën

Kërkesa e Fondacionit Evropian për trajnime (ETF) përkrahja e Kopenhagës është paraqitur si përkrahje teknike dhe financiare për masat nën a) dhe b).
Si plotësim Kosova do të përkrah bashkëpunimin bilateral në mes vendeve kandidate dhe vendet të cilat janë të bazuara në praktikën e Kopenhagës.
Sipas këtij vlerësimi përkrahja e CEDEFOP-it dhe ETF-it do të jenë të rëndësishme për t'i ofruar këshillime..

Fikrije Mustafa- Zymeri

Kordinatore e proceseve të Kopenhagës për Kosovën
Ministria e Arsimit ,Shkencës dhe Teknologjisë